



06 -07- 2017

Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Prishtinë / Pristina

Nr./Br. 1204-2017

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 pika (c), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ të KQZ-së Nr.01/2017 për Procedurën e Zëvendësimit të Anëtarit të Kuvendit Komunal, më 05.07.2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **ISMAIL KASUMI** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga subjekti politik "LDK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal **Flamur Shala**.
- II. Obligohet Kryesuesi i Kuvendit Komunal në Prishtinë, që ky vendim t'i komunikohet **Ismail Kasumi**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të kërkesës së Kryesuesit të Kuvendit Komunal në Prishtinë, të datës 04.07.2017, Nr.1188-2017, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Flamur Shala, pas dorëheqjes së tij të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye se është në pozitë udhëheqëse në Universitetin e Prizërenit.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, i cili është Ismail Kasumi, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuara të zgjedhjeve lokale të vitit 2013, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 05.07.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka

